

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME PETRIT SELIMIN

Prishtinë | Data: 18 prill, 2017

Kohëzgjatja: 50 minuta

Të pranishëm:

- Petrit Selimi (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

- () - komunikim emocional*
- { } - i intervistuarit shpjegon me gjeste*

Simbole të tjera në transkriptë:

- [] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

Fusnotat janë shtesa editoriale që jepin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Fillimiشت a mundeni me e prezantu veten?

Petrit Selimi: Unë jom Petrit Selimi.

Aurela Kadriu: Diçka rreth kujtimeve t'juja të fminisë, qasaj periudhe në të cilën jeni rritë, familja juj, shoqnia, shkolla?

Petrit Selimi: Unë kom lindë në Prishtinë në vitin 1979. Domethanë dekada e fundit e '70-tave, para demonstratave të 1981-shit, po unë nuk mbaj në mend fort këto çështjet politike, katër-pesë vjetët e para të fëminisë tem se pak a shumë prindt na kanë mbrojtë prej politikës. Ka pasë përshpërima, ka pasë brengë, ka pasë takime në kuzhinë midis prindve apo midis familjarëve, ku tash kur e menoj është ditë që gjanat nuk po shkojnë mirë.

Po fillimiشت fëminija ka qenë relativist e njëjtë si e fëmijëve të tjerë që jonë rritë në Prishtinë. Kem pasë tezen në Ulqin, kështu që verës kem shku në Ulqin, e kem ba atë rrugën – rruga dymbëdhjetë orë çdo verë. Kemi shku edhe në Greqi njihërë, çdo vjet, vitet e para të '80-tave. Kem pasë, unë kom shku në shkollën "Faik Konica" që atëherë e ka pasë emrin "Aca Marović", në çerdhe kom qenë këtu në qendër të Prishtinës mbrapa stadionit.

Nanën e kom pasë konservatore të librave të vjetër, babën e kom pasë sekretar në Gjykatën Kushtetuese. Kah ana e babës jonë prej anës së Bujanovcit, prej Nasalcës, një fshat, po kanë ardhë shumë herët, '50-tave, edhe babi shkollën e mesme e ka kry këtu, në Prishtinë. Kah ana e nanës jonë prej rajonit të Prizrenit. Gjyshërit edhe kah nana edhe kah baba jonë kanë prezencë e madhe te na në familje, kemi qenë familje e madhe të dyja anët.

Banesën e kom pasë në qendër të Prishtinës te "Rruga e Goleshit," që tash e ka emrin rruga "Rexhep Luci," realisht kafiqi apo kafiteria "Strip Depo" u kriju në banesë teme. Edhe aty kom jetu shumicën e fëminisë teme, po masi që kem qenë në qendër, kem pasë mysafirë tonë kohën, kushdo që ka pasë çfarëdo problemi në QKUK [Qendra Klinike Universitare e Kosovës] apo dokumente me nxerrë prej krejt Kosovës çfarëdo pozite u nalë njihërë... na jena kanë përdhesë, kështu që mu fëminija më ka kalu me mysafirë tonë jetën. Kanë ardhë kusheritë tonë me lujtë me lodrat tona, kanë ardhë kusheritë

me bujtë, nana jem ka pjekë pite të mira edhe baba jem herë pas here ka lujtë zhol me shoktë e vet, kështu që shpinë e kem pasë gjithë të mushtë me njerëz.

Edhe jom rritë në familje me plot kusheri të parë, të dytë, të tretë, edhe te na je konsideru familje e ngushtë edhe nëse je kanë dora e katërt, e pestë. Kështu që, këto kanë qenë vitet e para të fëminisë, nji jetë e cila ka qenë jo e pasun, mesatare, me nji çerdhe në Prishtinë, shkollë filllore poashtu në Prishtinë. Nana e cila ka insistu prej fëminisë me na msu gjuhë, kështu që e kom ditë edhe anglishten edhe serbishten para shkollës fill... në shkollë filllore i kom ditë mirë të dy gjuhët. Edhe italishten e kom msu se me nji periudhë. Nana, Violeta, e ka studiu patologjinë e librit, që është një shkencë kimike e përmirësimi apo shëndoshjes së letrës së vjetër apo librave të vjetër, në Romë. Kështu që, u munu me na msu edhe italisht. Kapak e di, nëse nalna pak ma gjatë nashta në Itali, e msoj ma mirë.

Aurela Kadriu: Okej. Petrit, a na tregon pak për qat' periudhën e shkollës. Domethanë, a iu ka ra me qenë në sistem paralel në atë kohë?

Petrit Selimi: Po realisht, kur ta kqyrë tash, ndoshta gjithçka ia ka nisë tamon në vitin '91, kur u suspendu autonomia. Edhe prapë po thom, masi që kemi jetu në qendër, në "Rrugën e Goleshit," çka ka pasë demonstrata kanë kalu kah rruga jonë. Domethanë, tenalt kanë ecë njerëzit me parulla, flamura, fotografi, teposhtë kanë ikë prej policisë, gazit lotësjellës, plumave.

Edhe unë prej ballkonit, terasës, dritares, kom pa t'u u zhvillu nji histori e shkapërderdhjes edhe të ish-Jugosllavisë, edhe fillimit të dhunës. Si fëmijë kemi qenë shumë të msum me gaz lotësjellës, se po thom, në qendër të Prishtinës, në kat përdhesë.... Mershim gotat e jogurtit, iu prejshim fundin edhe me gazë të lagtë, edhe qashtu rrishim me gasmaska në banesë. I kena msu shumë herët këto foret me kepë edhe me krejt mjetet e fundit që me e tejkalu gzin lotësjellës.

Është interesant, pritet edhe andrrat që jonë kanë qatëherë në fillim të '90-tave, me përnime çka ka ndodhë. '92-ta, Evropa '92, gjysa e restoranteve edhe kafiterive në Kosovë e kanë pasë emrin "Evropa '92," se u priti shumë që në '92-tën ka me u bashku Evropa edhe kemi me u ba te ton' Evropë. Toto Cutugno e ka pasë në Eurovizion kangën "*Insieme, Unite, Unite Europe*" bash në të '92-tën. Edhe këtu ka pasë nji dëshirë e madhe, e flaktë, mas ramjes së komunizmit që me qenë pjesë e nji familje ma të madhe, po natyrisht, absolutisht, e kundërtë e qasaj u kanë t'u ndodhë.

Dhuna ka shkaktu suprimimin e automisë, shkollat u mshelën. U kanë 1 shtatori, '91, në shkollë, atëherë "Aca Marović" e ka pasë emrin, ku policia veç ka thanë, "I keni pesë minuta me u largu," edhe na si fëmi jena çkapërderdhë, unë i kom pasë dymbëdhjetë vjet, në tana anët. Edhe masnej kom shku në shkollë private në qytezën "Pejton," në sistem paralel, në podrum koxha të ftoftë. S'ka qenë msim, ka qenë gjithçka veç msim s'ka qenë, kena lujtë, kena ba zhurmë, si me i shti tash... hallall iu koftë njerëzve që i kanë hapë shpijat, se kur ta menon tash me iu hapë 30-40 fëmijëve në moshën dymbëdhjetë vjeçare shpinë tane për çdo ditë, me mujë të tanë nuk ka qenë lehtë edhe për ata që kanë ndihmu.

Masnej jemi bajtë në shkollën "Emin Duraku" në "Kodrën e Trimave" që ka qenë sfidë në vete se është dashtë me ecë nëpër lagje ku shpesh i kanë ngucë çikat, është dashtë me shku me prind, ka pasë fëmijë ma problematik, kanë qenë njerëz ma të varfën, kështu që ka pasë nashta edhe njifarë lloj konflikti i heshtur social, pos atij etnik edhe ikjes prej policisë.

Masnej jom regjistru në "Xhevdet Dodë". Po qatëherë në vitin e fundit, në klasë të tetë kom qenë kur vjen nji anglez David Wilkom, në Kosovë edhe mu më thirrë nana e nji shoqes tem, shoqja e nji nanës teme, njana shoqe e nanës teme edhe thotë, "Po lypë nji anglez me u taku me fëmijë që dijnë anglisht," edhe jena taku më duket në banesën e Pasionare Xharrës ose Lyra Xharrës, nuk po më kujtohet as cila ka qenë prej këtyre motrave, nja dhjetë-pesëmdhetë fëmijë edhe kena folë me këtë anglezin për brengat tona, për shpresat tona, eksperiencën tonë.

Atëherë veç u kanë t'u hi me nji zonë të zymtë ekzistenza në Kosovë, krejt prindët na qitën prej punës. Prej nji klase relativisht të mesme, u bamë ton' fukara. Krejt nanat ja nisën me ba bukë në shpi, me ba çokollatë në shpi, te tona ma të kqija se origjinali. Edhe kena kalu mirë dy-tri orë aty çka kena folë. Kur, do mujë ma vonë thirrë dikush në shpi edhe thotë, "Kishin me ardhë me nji festival të fëmijëve..."

Aurela Kadriu: Veç pak në qat' takimin, më fal që po të ndërprej...

Petrít Selimi: Po.

Aurela Kadriu: ...a ka pasë veç fëmijë shqiptarë, domethanë veç kosovarë, apo kanë qenë edhe serbët?

Petrít Selimi: Po, veç fëmijë shqiptarë kanë qenë. Jo s'më...

Aurela Kadriu: Ndoshta edhe pak para se me kalu te qajo periudhë, kisha dashtë me më tregu pak bashkë-ekzistencën, bashkëjetesën e juj me fëmitë serbë. A keni pasë shokë, shoqe serbë derisa ndodhi ndarja?

Petrít Selimi: Kqyre, të thom shumë sinqerisht, nuk o që ka qenë bash që kemi pasë shumë shokë apo shoqe. Fillmisht, nuk kom qenë fëmijë që dal shumë, unë jom mbyllë në Bibliotekë Kombëtare te nana, kom marrë stripa edhe libra edhe kom hy ndër tavolinë e kom lexu me orë të tana. Kështu që, s'jom kanë fëmijë që ka dalë jashtë me lujtë futboll me fëmijë të tjerë.

Në shkollë fillore jonë kanë klasët shqiptare e klasët serbe, por nuk është që ka pasë shumë prekje mes tyne. Tash, t'u jetu në qendër, natyrisht që në qendër ka pasë ma shumë serbë se kudo tjetër në Prishtinë. Gjysa e popullatës më duket në qendër kanë qenë serbë. Në hymjen teme, në "Rrugën e Goleshit" atëherë, tash në rrugën "Rexhep Laci," gjysma kanë qenë serbë. Kështu që, kem pasë kontakte sporadike, po shokë edhe shoqe s'kom pasë serbë.

Se, veç deri në të '91-tën gjanat pak u patën nda, nuk është që ka pasë ndonjë dashuri të madhe midis shqiptarëve edhe serbëve mas 1981-tës, edhe senet çdo vjet t'u shku kanë qenë t'u u ba ma të zymta e ma të zymta. Kështu që, nuk kisha mujtë me thanë që e kom pasë naj Ivan a Milan shok, se s'kom pasë, thjesht nuk m'ka ra me pasë shokë në shkollë fillore. Po, natyrisht, kena bashkë-ekzistu, nëse jo bashkëfolë edhe bashkë... se qaty jena kanë në qat' qytet.

Po në '91-tën, prindët jonë kanë shumë nervoz në serbë, te ton' jonë kanë shumë nervoz se ata metën në puna, jo që metën në puna po i murën edhe puntë e prindve tanë. Edhe masnej prej të '90-tës domethanë.... E mbaj në mend, bile bile, Bob Dole pat' ardhë, senatori Dole me kongresmenin Lantos në Kosovë në nji vizitë në "Grand Hotel" edhe patën dalë shqiptarët me e taku, me mijëra shqiptarë te dyrtë e "Grand"-it. Edhe serbët, policia debilla qysh jonë kanë ia kanë nisë me i njekë edhe me i rrehë njerëzit përpara, para syve të delegacionit amerikan.

Edhe e maj n'men që edhe baba i pat' hangër do pendreka se erdh në shpi i rrehtë pak, edhe qajo ka qenë periudha që me nji anë politika e okupoi fëmininë tonë. Realisht, fëminija jonë përfundoi, nëse ke pasë çfarëdo fëminije deri në qat' periudhë edhe ndoshta e ke pasë brengë, "A muj me ble Commodore 64-shin, kompjuterin" edhe, "a mujna me shku në Greqi në pushime," prej asaj periudhe ma s'ka pasë brenga të tilla se te ton' jonë kanë pa punë, pare s'kena pasë edhe gjithçka u kanë politikë. Edhe ndoshta aty masnej veç nji brengë u kanë që kur ka pasë demonstratë mos me dalë prej banesës që mos me na rrokë naj plumb apo naj mori e njerëzve t'u ikë, t'u ngajtë.

Edhe krejt qata njerëz që kanë lindë në qat' periudhë, në qat' gjeneratë pak a shumë e kanë pasë të premë filmin qatëherë në '90-tën, edhe filmi ka vazhdu në '99-tën. Edhe është një dekadë e humbun e fëminisë për ata që jonë kanë fëmijë, e pjeturisë për ata që jonë kanë të mdhaj. Baba jem në '91-tën u kanë sekretar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës... të Krahinës së Kosovës, po ka pasë Kushtetutë, ka pasë Gjykatë Kushtetuese. Në '99-tën s'ka ditë anglisht edhe u kanë jurist i papunë edhe bota ka ndryshu edhe u dashtë me ditë internet edhe krejt ato sene që kanë ndodhë të '90-tave. Neve na kanë ikë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë diskursi i ligjërimit në shkollë në sistemin paralel në qat' kohë edhe në familje qysh iu është folë juve, çfarë këshillash iu kanë dhanë prindërit. Çfarë diskursi... në qat' kohë kur iu ka mohu identiteti kombëtar?

Petrif Selimi: Shkolla fillore, po thom prapë, ka pasë shumë pak msim se s'ka pasë fokus. Jena ngucë ma s'pari numër një. Fakti që ndrrohet politika nuk domethanë që çikat nuk ngucen me djemtë e djemtë nuk ngucen me djem. Kur je në shkollë ajo menaxhohet edhe strukturohet edhe ki msus që t'nalë, po kur je në podrum qaty mshelun dymbëdhjetë orë s'ki ku ikë edhe s'ka kush e menaxhon atë situatë. Edhe aty veç, nëse jena rrehë për shembull djem me djem t'u lujtë në shkollë fillore në oborr edhe ka ardhë msusi i ka nalë, kush i nalë me nji podrum me u ngucë fëmitë mes veti?

Kështu që, kurgjo s'maj në men prej ligjërimit në atë periudhë se veç m'duket njifarë periudhë gjysmë-fun [qejf], e edhe kurgjo kaotike qato vitet e para të shkollës paralele. Po, natyrisht, që u ndrru krejt në aspektin që nëse të '90-tave librat e kanë pasë në faqe të parë Josip Broz Titon edhe u folë për vllaznimin edhe bashkimin edhe vjershat jonë kanë për "Boro-Ramizin" edhe kur patëm shku në klasë të tetë në ekskurzion kemi shku te "Landovica," përmendorja e "Boro-Ramizit" edhe gjithçka u kanë e dedikume qatij diskursit jugosllav.

Edhe në ndërtesën që është tash Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka qenë grafiti i Titos, "Prej fjalëve në veprat!" Edhe ajo fjala tjetër ka qenë, "Ruajeni bashkim-vllaznimin si sytë e ballit!" Edhe qito kanë qenë domethanë motot operative të sistemit arsimor. Masnej krejt u ndryshu përnjiherë, po më duket edhe msusat menxi jonë gjetë tash me ndryshimet e reja, po është ditë që, "Serbia është armiku, qita na ndryshun jetën, na qitën prindët prej punës".

Ja nisën me vra njerëz, njshe emra si Ylfete Humolli, si... studenta domethanë që kanë vdekë. Na kena pa, unë e maj në men bash ku jom rritë mas protestave, ka pasë pastaj këto kamionat që i kanë pastru rrugët që mos me u pa gjaku në sabah. Edhe qito kanë qenë përshtypjet.... Për shumë njerëz ka qenë edhe çashtje ekzistenciale, me mbetë gjallë, domethanë me hangër, me mbetë gjallë *as in food* [pra, ushqim], kështu që shkapërderdhje totale e normave edhe vlerave që e bajnë dikon njeri.

Po në anën tjetër fuqizim edhe rritje e njifarë solidariteti intern. Qatëherë u banë edhe partitë e para politike, nëpër shkolla shkrujshim, "Kosova Republikë," edhe "LDK," qato grafitet e para të '91-tës.

Edhe po menoj, media të huja s'ka pasë, radio "Evropa e Lirë" ia nisi me u dëgju shumë nëpër radio, edhe radio "Zagrebi" si kanale të vetme të informimit, se natyrisht u mshelën këto gazetat edhe radiotelevizonin.

Në anën tjetër masnej edhe bota ia vnoi sanksionet ekonomike Serbisë meniherë ma vonë në '92-tën, për shkak të pjesëmarrjes në Bosnje, edhe u degradu komplet edhe ekzistenza ekonomike në aspektin që ti s'ke pasë ma sene me ble, ti u dashtë me pritë në rend me ble bukë, gjatë, ose qumësht, me shku në mëngjes herët në pesë ose gjashtë para "Voçarit" ose "Gërmisë" me pritë katër-pesë orë se ka pasë sasi të limitume të qumështit.

Edhe ia ka nisë "Shferci," qata njerëz që jonë kanë pak ma të gjindshëm, shkojshin në Turqi blejshin sene e shitshin kështu.... Kështu që, ka pasë shkatërrim total në Kosovë i shkaktum prej okupimit serb, po edhe nji mega shkatërrim në krejt Jugosllavinë, lufta në televizion, vrasje, Bosnja, masakra, qito jonë kanë lajmet e fillimit të '90-tave. Lufta në Kroaci u kanë e përcjellun shumë te na edhe lufta në Bosnje u kanë e përcjellun shumë te na se jonë kanë të frigum që ka me zhdrypë te poshtë, që ma në fund edhe ndodhi, edhe jonë kanë të tmerrum.

Edhe kur e maj qitash në men, qitash jom babë i nji fmisë vetë, koxha paska qenë e tmerrshme pasiguria e prindve që nuk e dijnë çka ka me u bo tash me fëmitë e tyne. Shumë njerëz kanë dalë në diasporë qatëherë, shumë njerëz na kanë dalë jashtë, kanë shku jashtë, fëmijë të axhës, kusheri të ndryshëm, fëmijë të tezës, edhe përnjihëri ia nisën me u tëhollu rrathët e familjeve tonë me shumë njerëz që fillun me u zhdukë prej Kosovës.

Aurela Kadriu: A mban mend diçka prej jetës kulturore në qat' kohë, "Kurrizi," "Qafa"?

Petrif Selimi: S'ka qenë jetë kulturore, ka qenë jetë akulturore. Po, po, e mbaj në mend kur kom dalë për herë të parë me pi *vodka-schweppes* në "Kurrizi". "Kurrizi" ka qenë qatëherë i ka pasë do kafiteri, atëherë iu thojshim kafiqë. Edhe e mbaj në mend në vit të parë kena shku Këershëndellat në Kishë Katolike me i pritë se u dilke mandej. Tash paramendo s'ka pasë telefona mobil, natyrisht që s'ka pasë edhe telefonat fiks herë kanë punu herë s'kanë punu, dofarë me numra kështu që u sillshin. Edhe p'e paramendoj kur kena shku dalë na në mbramje në qat' kohë, sa jonë kanë të tmerrum prindët tanë që s'kanë mujtë as me ditë ku jena, as çka jena t'u ba, po në anën tjetër qysh me na nalë në shpi?

Aurela Kadriu: Qysh i organizojshit qato takime meqenëse atëherë nuk ka pasë mjete të komunikimit?

Petrif Selimi: Uff... telefona fiks, qashtu u gjindshim diqysh. Edhe mramjeve kena dalë. Mramjeve muzikore që i bojshin reperat edhe rokerat e parë, hala atëherë u kanë prezent që është hala sot, BB Poqi, Ilir Bajri, do prej ktyne reperave fillestarë të atëhershëm. Ma vonë ia pat' nisë edhe Memli edhe "Ritmi i rrugës", po realisht "Kurrizi" u kanë pika e destinimit. Masnej në "Qafë" në kat të dytë.

Po në shkollë filllore në klasë të tetë u kanë "Elida". Në "Elidë" ti ke shku me hangër naj ambëlsinë, me mujtë me ikë diqysh pa pagu. Unë njihëri pata ikë, e kom harru çantën mrena në asi, kështu që u dashtë me u kthy diqysh. E, s'kishim pare, i kishim te ton' t'ima, hekra, kur kishe pare me ble hamburger edhe Coca-cola, dita kryesore e javës. Edhe, hala, a din u kanë nji rrëzim total njihëri e tek masnej ia ka nisë kapak-kapak diqysh me u munu njërëzit në qat' kontekst me kriju diçka, me mjellë

do fara pak diçka do gjelbrim kulturor me u kriju në nji shkretëtinë totale të vobektësisë financiare, ekonomike, represionit politik edhe nji situate relativisht të pashpresë, kështu.

Aurela Kadriu: Mandej, çka ndodhi me juve mas klasës së tetë, mas shkollës fillore?

Petrit Selimi: Në klasë të tetë u kanë qajo kur.... Unë s'kom shku në gjysëm-maturë për shembull se qaj Davidi që e përshkruva ma herët që ka qenë në Prishtinë, ai ka folë me do fëmijë, ai thirri në telefon iu tha prindve të mi, "A munet djali juj me ardhë në Austri me nji konferencë në të '92-tën për të drejtat e fëmijëve?" Edhe ajo u kanë bash në periudhën qatëherë në qershor kur u kanë fundi i klasës së tetë, menxi e kena pritet gjysëm-maturën me kcy sentisha me çika, edhe për herë të parë me pasë kontakte kështu pak ma... potenciale me gjininë e kundërt. E unë s'jom kanë aty, paramandoni, m'u ka dashtë me shku në Austri në qet' konferencën, bashkë me Pasionaren më duket edhe me Lyrën jena kanë.

Edhe me shku atje u kanë koxha njifarë sfide se aeroplana s'ka pasë Prishtina, as Beogradit s'ka pasë aeroplana se u kanë në sanksione, kështu që kemi shku me nji kerr të vjetër me nji Mercedes të axhës Elez që sot jeton në Gjermani, deri në Suboticë, prej Suboticës masnej na patën dalë do hungarezë me na marrë, na çunë në Austri me nji katun, Nürsteg, plot fëmijë prej krejt botës edhe pak si mrekulli.

Kur u nisa në rrugë te ton' shumë krenarë me Petritin që po shkon në konferencë, dhjetë marka nji axhë, njizetë marka tezja, i bona nga katërdhetë marka që u kanë shumë për nji fëmijë. Edhe patëm kalu nga nji javë më duket në qat' konferencën e fëmijëve. Masnej shkum në Vienë edhe e mora vesh që kjo konferencia është pjesë e nji konference ma të madhe për të drejtat e njeriut.

Aty u kanë edhe Dalai Lama edhe liderë të shteteve të ndryshme. Na e kem prezantu situatën e të drejtave të fëmijëve në botë para qasaj konference të madhe ndërkombëtare. Atje sa kem i takum edhe do persona të tjerë, Kristin Eskeland prej Norvegjisë, Wernerin e Austrisë. Ishin udhëheqës të OJQ-ve të ndryshme të mdhaja, edhe erdh ideja, jena kanë nji kroate, Daniella, nji serb i Beogradit, Ivani edhe unë. "Pse s'po tentojmë nji diçka të tillë, nji konferencë të tillë edhe nji ngjarje të tillë me e dediku vetëm për fëmitë e rajonit tonë?"

Aurela Kadriu: A e përfaqësojshit atje gjendjen politike në Kosovë?

Petrit Selimi: Natyrisht, po...

Aurela Kadriu: Qysh e keni transmetu?

Petrit Selimi: Jena kanë të gjithë shumë politikisht të vetëdijshëm. Edhe jena kanë koxha do terrorista të vegjël në aspektin e zhurmës së madhe që e kena ba për Kosovën edhe për situatën e gjendjes me të drejtat e fëmijëve. Edhe kena pasë rrëfim që u kanë autentik, u kanë original se shkollat na u mshelën, prindët na i qitën prej punës. Kujt do që i ke tregu situatën...

Në anën tjeter kish edhe boshnjakë, ata përjetojshin masakra, krime, gjenocid. Kështu që, situata në përgjithësi ka qenë e tillë që më nji anë, pjesa ma e madhe e Evropës hike me nji periudhë së ramjes së murit të Berlinit, ramjes së Bashkimit Sovjetik, fillimin e demokracisë. Pos në këtë ishullin e Ballkanit ku Serbia filloi nji fushatë masive në shumë shtete të konfliktit, apart-heidit, e diku-diku edhe gjenocidit. Kështu që, ka qenë rrëfim që për te ton' i prekshëm (teshtin). M'fal! {i drejtohet intervistues}, jom i ftofun pak, kështu që...

Aurela Kadriu: Lirisht vazhdo qaty ku mbetët, qysh jeni taku me...

Petrit Selimi: Edhe u takum me ata liderët e OJQ-ve në Austri, vendosëm, "Hajde po bajna diçka vetëm për ish-Jugosllavi", iu pëlqeu ideja. Unë atëherë i kom pasë 14 vjet, edhe masnej u ktheva në vitin e parë në shkollë të mesme këtu në "Xhevdet Dodë" edhe u takum me do fëmijë, të ri këtu që i njifshim, që ishim shokë mes vete edhe e bonëm njifarë celule të parë, fillestare të nji aktivizmi rinor.

Masnej kom shku dy-tri herë në Austri edhe Norvegji me ba planin qysh me organizu këto takime, këtë organizim të të rive. Edhe ka qenë interesant se atëherë s'ke mujtë me udhëtu hiç, kur ke udhëtu, ke udhëtu për me shku në azil. Kështu që, unë shkojsha në Austri e Norvegji edhe u kthejsha, edhe koxha iu duke interesant njerëzve.

S'ka pasë OJQ-ja hiç në Prishtinë, s'ka pasë mundësi me dalë jashtë vendit edhe ka qenë koxha njifarë inovacioni me kriju diçka prej zeros në Kosovë ku krejt u kanë minus. Kështu që, qatëherë qai grupi i parë i shokëve që ishim në shkollë të mesme në "Xhevdet Doda" u takum edhe vendosëm, do Jonë kanë në klasë teme, do kanë qenë në klasë paralele, me kriju njifarë organizmi, organizimi. Su kanë bash ideja e qartë, ku kishim me ba diçka do projekte të kulturës, të artit, gazetarisë, domethanë njifarë lëvizje që kish mujtë me e kompenzu pak mungesën totale të çfarëdo aktiviteti të lirë në jetën tonë.

Ajo u pritë mirë me miqtë ndërkombe të atëherë edhe e përkrahën idenë. Edhe fillum çdo vjet u majshin konferencat, ndoshta edhe dy herë në vjet në Austri, bash në qat' fshatin Nürsteg ku kemi qenë pjesëmarrës të ndryshëm që kena shku nga ish, republikat e ish-Jugosllavisë, domethanë nga shtatë fëmijë kena qenë gjithmonë, fëmijë edhe të rritun. Rrethi jonë veç u rrit, qysh jena kanë pesë-gjashtë veta u bonëm dhjetë-pesëmdhetë, u bonëm 20-25. Vendosëm që në Prishtinë ta çelim edhe nji qendër rimore, nji lloj zyre. Vendosëm me çelë nji lloj zyre që kish me u marrë me aktivitete, me ekspozita.

Erdhën norvegjezët këtu, qajo Kristina edhe u pajtum që banesën teme me e përdorë si nji lloj objekti takues. Para asaj u takojshim nëpër shpija ashtu-kështu, nëpër shpija të ndryshme, u takojshim nëpër shpija të ndryshme. Unë e kom pasë në qendër banesën edhe ishte ndoshta ma s'lehti me fillu punën aty. U kriju njifarë *youth center*, qendër rimore, kishim takime, kishim ekspozita, kishim ngjarje.

Organizonim pastaj edhe mboramje muzikore nëpër qato objekte që kanë qenë, kafiteri të ndryshme. Kështu që njifarë... fillum me botimin, nji shtojcë e gazetarisë rimore në kuadër të revistës atëherë "Koha Javore". Sa jena kanë na Austri erdh edhe puna e emrit, "Qysh me qujtë vetveten qiky rrjet i organizatave në ish-Jugosllavi?" Edhe u kanë nji intervistë e Leonard Cohen-it, të cilin e vesin, këngëtarin e famshëm kanadez i cili vdiq vjet, "A je optimist a je pesimist?" Edhe ai pat' thanë, "Unë jom post-pesimist". Edhe u kanë njifarë emri ndoshta adekuat për periudhën ku kemi qenë, se me qujtë tash veten "Lulediellat e Ballkanit" në kohën kur u kanë tmerr total, u kanë pak si naive. Po qysh me shprehë tash dëshirën tonë që me dalë prej kurthës së pesimizmit edhe defetizmit edhe me luftu edhe me ba diçka, po mos me qenë emën super-optimist. Atëherë, dikush pat' propozu emrin "Post-pesimistët" edhe mbet qaj emën i organizatës edhe u përdor shtatë-tetë vjet si platformë e veprimit politik, kulturor, artistik të nji gjeneratë të madhe të të rijve të Prishtinës.

Aurela Kadriu: Çfarë keni bo ju në "Post-pesimista," çfarë ngjarjesh keni mbulu, domethanë po flasim për shtojcën, për gazetën...

Petrit Selimi: Unë kom qenë njëni prej gazetarëve të shtojcës "Post-pesimistat," kryeredaktore ka qenë Garentina Kraja më duket. Masnej patëm fillu edhe një revistë tjetër me botu, stinore, për stripa, kulturë, alternative, e ka pasë emrin "Hapi Alternativ". Atëherë veç u pat' çelë fondacioni "Soros" edhe e murëm një grant prej tyne. Kjo ka qenë revistë e cila ka synu me kompenzu pak mungesën totale të informatave sa i përket atëherë kulturës së të '90-tave me thanë, shprehjes ma alternative artistike, edhe e kem botu ata si një revistë të dytë.

Kem pasë koxha do *party* [ndeja] me thanë të muzikës, atëherë që hini në treg muzika elektronike, muzika *grunge*, kështu që kemi ndihmu shumë bendet kosovare me prodhun, me ba mbajtje muzikore. Ka pasë disa shfaqje teatri alternative, Jeta Xharra u marrë me teatër. Në kuadër të "Post-pesimistave" gjithmonë ka qenë edhe njifarë dege koxha distinktive e teatrit edhe e shfaqjeve, s'ka pasë, Teatri Kombëtar ka qenë mshelë, po në lokacione alternative ku u mbajtë komplet jeta.... E mbaj në mend që nuk ka pasë kurrfarë objekti zyrtar, ke mujtë me ba çkado, kështu që ekspositat e artistave ma të mdhej kosovarë Muslim Mulliqi, çka po di unë, njerëzit kanë majtë nëpër kafiteri, koncertet jonë majtë në kafiteri, mramjet poetike jonë majtë në kafiteri. Çkado që ka pasë diçka, qajo u kanë i vetmi platformë ku ti ke mujtë me shprehë çfarëdo veprimi artistik.

Aurela Kadriu: A ka pasë ngjyrime politike në "Post-pesimista"? A i raportojshtit ju ato rrahjet, dhunën, vrasjet që ndodhshin?

Petrit Selimi: Gjithmonë! Kur na kanë ardhë vizitorë nga jashtë gjithmonë kemi shku në KLMDNJ [Këshilli për Liritë dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut]. KLMDNJ-ja ka pasë atëherë bacin Adem si kryetar edhe shkojshim te selia e Qendrës së Shkrimtarëve që ka qenë atëherë LDK-ja. Me profesorin Fehmi Agani jemi taku shpesh. Kemi pasë *workshop-a* [punëtori] për gazetari, gjenerata e gazetarëve si s'po di, Ylber Hysa, Dukagjin Gorani, pastaj do veprimtarë të të drejtave të njeriut, të gjithë ata kanë majtë *workshop-a* te na edhe punëtori të ndryshme edhe ka qenë koxha e fokusume në realitetin tonë i cili ka qenë super-politik edhe intervistat që i kemi ba jashtë edhe botimet që i kemi dërgu jashtë gjithmonë kanë qenë të fokusume në tregimin e realitetit tragjik të Kosovës, asaj s'ke mujtë me i ikë.

Kështu që, në një mënyrë je munu me i kriju do vlera, do veprime të rezistencës që, "Nuk kemi vdekë totalisht," që, "Jemi t'u prodhu diçka," e në anën tjetër jashtë je munu me tregu atë tragjedinë që ka ndodhë në vend. Kështu që, mrena ka pasë një veprim iluminues, nëse kisha mujtë me përdorë fjalën pa qenë pretencioz, e jashtë ka pasë informues, domethanë me tregu çka po ndodhë në Kosovë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë me punu në qat' presion. Unë kom lexu shkrime ku ju keni raportu edhe për vrasjen e shokëve të juj, ose vrasjen e të rijeve në atë kohë, edhe diqysh kjo krejt në qat' pikturen e madhe, po tingllon pak si veprim, në atëbotë, ilegal, diqysh *underground*.¹ Qysh ka qenë me punu nën qat' presion në qendër të qytetit me pasë selinë edhe ju me ba ecejake në qytet në qat' kohë?

Petrit Selimi: Kur ta meno qitash, isha tmerru fëmiju jem me ba diçka që ka qenë qashtu gjysëm-illegale, me shkru.... Po a të tregoj edhe diçka tjetër, Milloshevici me gjasë fort s'i ka interesu rezistenca paqësore edhe çka po shkrujnë gazetat. Se ke pasë ti edhe gazeta në Beograd që jonë kanë koxha opozitare, edhe këtu "Bujku" ka dalë, një gazetë ditore në Kosovë që ka ekzistuar që ka shkru njisoj sene shumë politike.

¹ *Underground*: bukvalisht, nëntokësor, në këtë kontekst, i rrezikshëm, i jashtëligjshëm.

Ti ke pasë revista "Zëri" edhe revista "Koha Javore". Televizion s'të ka lanë me pasë, televizionin e ke kqyrë televizionin e Shqipnisë, atje e kishin nji orë program të Kosovës qita spikerat tonë të famshëm. Po, realisht Serbia ia ka nisë m'u tundu edhe m'u frikësu edhe me reagu egërsisht veç kur modaliteti i veprimit të kosovarëve ka ndryshu edhe u ba pak ma, pak ma i, agresiv jo po pak ma aktiv edhe kundërshtues.

Jonë kanë atëherë do legjenda, për shembull thojshin, "Në Drenicë jonë do fshatra ku policia s'mun me hi, jonë krejt tanët". Edhe i maj në mend këto muhabete të '90-tave, kah '94-5. Natyrisht, s'e kom ditë atëherë, po fjala ka qenë për Prekazin edhe për komplet rajonin ku qatëherë veç ia ka nisë nji rezistencë për të cilën na nuk e kena ditë në Prishtinë, po që njerëzit kadal-dale ia kanë nisë me pa që vetëm t'u nejtë nuk ka mundësi me dalë prej qarkut vicioz të okupimit.

Edhe, qatëherë veç edhe këtu ia nisen do protesta studentore këtu në të '97-tën. Po kjo ke veç nji episodë tjetër se unë në të '96-tën kom shku në Norvegji. Diplomati norvegjez Kai Eide edhe ish-kryeministri Tavas Holterberg më shofin mu në nji konferencë ndërkombëtare, po get iu pëlqej, nuk e di taman *background-in* [prapavijën] edhe kanë shku te prindët e mi edhe kanë thanë, "Po dojna qit' djalë me e mundësu me u shkollu në Norvegji". Edhe në të '96-tën, taman vitin e tretë e përfundoj unë këtu, unë shkoj në Norvegji me jetu. Kështu që, edhe mramjen e maturës në shkollë të mesme s'e kom priti në Prishtinë, të dyjat më kanë ikë.

Kom shku në Norvegji, atje kom vazhdu masnej me nji koleg një gjuhën angleze. Kom jetu në familjen e ish-ministrat të punëve të jashtme të Norvegjisë, Kai Eide, në shpi të tij, në familje të tij. Edhe masnej kom ardhë çdo verë në Kosovë, natyrisht, kom kalu kohë të shpeshtë këtu. Por në '97-tën kur ia nisen protestat edhe veç '98-ta kur hinëm një konflikt, aksione direkte edhe kur ndodhi masnej sulmi në Prekaz edhe vrasja e Jasharajve veç ia nisi nji rrugë pa kthim, e cila u dike që ja ka me dalë shumë keq, ja diçka ka me ndodhë.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: Cili ka qenë qëndrimi i qatyne strukturave paralele shtetnore, kosovare ndaj veprimit t'juj në "Post-pesimista" në atë kohë...

Petrit Selimi: A din qysh...

Aurela Kadriu: ...a ka pasë naj qëndrim, a ka pasë zana që kanë ardhë prej atje, a iu kanë mbështetë, a iu kanë kundërshtu?

Petrit Selimi: ...na kena qenë koxha të vegjël në krahasim me rrëfimin e madh që ka ndodhë atëherë. Qata pak njerëz që jonë marrë me këto aktivitete, sidomos në fillim të të '90-tave jonë ndihmu mes veti. Domethanë na kemi pasë gjithmonë kontakt të mirë, korrekt me qato struktura që kanë qenë atëherë. A ka pasë diçka në formë të financimit? Jo. Na kena pasë buxhete që tash kur i menoj, qesharake kanë qenë, prej Norvegjisë, nashta njimijë-dymijë mark atëherë për nji buxhet gjashtë

mujor, s'e maj në men taman buxhetin sa ka qenë, po që për këto ka qenë shumë, ke mujtë me qitë gazetë, ke mujtë me qitë... me ba organizime të ndryshme.

Po veç atëherë ka '95-ta, '96-ta, '97-ta ia nisën pak me u ringjallë do shtylla të reja të veprimit. "Koha Javore" u ba "Kohë Ditore" edhe shumë prej gazetarëve edhe prej të rive të "Post-pesimistave" që jonë kanë në Prishtinë u banë gazetarë të "Kohës Ditore". Domethanë ndoshta 80 përqind të komplet "Kohës" kanë qenë themelus të... gazetarët e parë kanë qenë të workshop-ave të... që kanë dalë prej qendrës së Post-pesimistave, që u banë masnej redaktorë, tash që jonë... Fis Abrashi është shefi i AP-së [Associated Press] në Evropë Qendrore, Beni Qena është shefi i AP-së në Jerusalem. Gazetarë të ndryshëm tjerë të famshëm që jonë sot në krejt Kosovën edhe mbarë botën e të cilët kanë qenë... thelbi ka qenë në qat' grupin e parë të "Post-pesimistave".

Aurela Kadriu: Cili ke viti që u përbilly zyrtarisht "Post-pesimistët"?

Petrit Selimi: Po s'ka pasë vit kur tuk u përbilly. Edhe mbas luftës ka pasë gjenerata që jonë marrë me aktivitete, kanë pasë zyre, qendër rinore. Po mbas luftës, 2000-2001 veç ndodhi këtu nji eksplozion i jashtëzakonshëm i donatorëve, domethanë, qaq shumë OJQ jonë çelë, qaq shumë ka pasë pare, me qindra, miliona euro po folim që kanë hi në tylifar aktivitete që... krejt ata që jonë kanë të "Post-pesimistave" kanë hi në punë që ku me ditë sa të vegjël me kanë, 18 vjet, kanë ditë anglisht, kanë pasë, edhe përnjipherë nevoja e ekzistencës, është ajo fjala franceze, "Pushoi se..." nuk kish ma nevojë më pasë "Post-pesimista".

Nëse u kanë pjesa, rezistenca edhe puna edhe zhvillimi kulturor në nji shkretëtinë kulturore, ma rezistencë s'ka pasë nevojë me pasë domethanë, se u shliru Kosova edhe dy, konkurrenca e madhe e fondeve edhe e OJQ-ve edhe e të tjerëve që ishin shumë ma të mdhaj edhe ma interesant në nji mënyrë implodoi organizatën.

Kështu që, s'ka pasë ndonji datë definitive që, "U mshel edhe nuk ka ma 'Post-pesimista'", po veç njerëzit u rritën, gjeneratat e dyta e të treta të "Post-pesimistave" poashtu nuk.... Vazhdun me jetët e tyre, dulën me shkollime jashtë, shumë prej tyre. Kështu që, ke njifarë vdekje e natyrshme, me e qujtë, e komplet lëvizjes. Po, e cila nuk ka qenë vdekje se qai shpirt edhe qai aktivizëm edhe qajo ndjenjë progresive e ndryshimit ka mbetë me njerëz që sot jonë t'u punu në krejt Kosovën.

Aurela Kadriu: A e ka pasë emrin e njëjtë lëvizja edhe në Kroaci edhe në Serbi...

Petrit Selimi: Po. Po, po.

Aurela Kadriu: Edhe a keni pasë kontakte me njerëz prej...

Petrit Selimi: Kena pasë... ndërkohë, mas luftës, a?

Aurela Kadriu: Jo, po mendoj atëbotë, a keni pasë naj aktivitet të koordinum?

Petrit Selimi: Po, u takojshim në Austri. S'u kanë koordinim, po jonë kanë, kur shkojshim në Austri kishim domethanë çka bojshin ata në Zagreb organizata e tyne, çka në Beograd organizata e tyne. Po muj me thanë lirisht që e jona ka qenë ma aktivja edhe ma e sofistikumja. Na kena pasë edhe zyre edhe aktivitete, kemi shkrujtë propozime të mira. Kemi pasë koxha njifarë lloj, me thanë, për atë kohë, nji veprim i komplikum edhe kompleks që u kanë shumështresor. Kështu që, kemi qenë ma aktivët po

ka pasë nëpër krejt ish-Jugosllavinë qendra apo pikë apo zyra të “Post-pesimistave” me ma shumë apo ma pak sukses.

Aurela Kadriu: Kur shkut në Norvegji, familja juj vazhdoi me mbetë në Kosovë, a po?

Petrit Selimi: Po, po.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë për juve qajo periudhë? Ju keni qenë në Norvegji, në Kosovë ka pasë trazira, familja juj këtu?

Petrit Selimi: Vitin e parë kom kajtë ton’ kohën. E maj në men kur m’patë përcjellë halla jem e cila e bojke njifarë pite e mirë, quhet në Anamoravë samcë, është pite me kos edhe me hudra. Edhe, kajsha për samcë në Norvegji, “Po më hahet samca,” për hallën tem, për nanën, për babën. Tash, t’u mos pasë shumë pare, folshim në telefon ndoshta njihëre në javët apo dyherë në javët, me telefon prapë statik.

Edhe, nuk mujsha me u msu se Norvegjia koxha e ftoftë është, njerëzit nuk përqafohen mes veti edhe nuk preken fizikisht kështu, as dorën s’ja jepin njoni-tjetrit në mëngjes. Po kjo është veç derisa të msohesh me ta, të hin mrena në familje, se përndryshe jonë shumë të ngrohtë. Po kështu *externally* [nga jashtë] nuk jonë fort njerëz si na, të themi pjesa mediterane, juglindore e Ballkanit ku ka shumë ma shumë emocion në marrëdhanie njerëzore.

Kështu që, viti i parë u kanë koxha i vshtirë, veç vetë, prindët i kom pasë në Kosovë. E kom pasë nji stipedion që m’i ka mbulu shpenzimet, po jo jetë luksoze natyrisht. Jom kanë me nji shkollë ku ka pasë shumë fëmijë të pasun, fëmijë të ambasadorëve, fëmijë të milionerave norvegjezë. Tek masnej në vitin e dytë kom arritë me u integrus edhe m’u integrus koxha mirë në aspektin që masnej shkojsha bujsha, kom pasë shokë. Kom ba shokë, ndër shokët ma të mirë që i kom sot në jetë jonë prej periudhës kur e kom kalu shkollën e mesme në Norvegji.

Aurela Kadriu: Mandej çka studiojshit, Petrit, a e keni vazhdu?

Petrit Selimi: Po, masnej në të ‘98-tën përfundova shkollën e mesme në Norvegji edhe e registrova menihere fakultetin në Oslo. Fillimisht teologji, apo shkenca biblike, se m’ka interesu shumë feja, jo pse jom kanë fetar, bile e kundërtat. Po, masnej e kom ndërrru, masnej nji semestër kom dalë në Antropologji Sociale, e kom marrë nji semestër edhe Urbanizëm.

Kështu që, kom studiu Urbanizëm edhe Antropologji apo “Efektin e ndryshimeve të peisazheve fizike të qyeteve në struktura sociale” u kanë tema jem m’duket e diplomimit. E kom kry meniherë mas luftës fakultetin edhe kom ardhë këtu kom punu me nji projekt që e ka pasë emrin “Internet Projekt Kosova” që masnej u qujte “IPKO”. Edhe jom kanë në atë ekipin e parë që e ka themelu “IPKO”-n, edhe kena punu në ndërtuesën e ish “Boro-Ramizi” këtu në qendrën sportive, në 2000-2001-2002.

Aurela Kadriu: Para se m’u kthy në Kosovë, qysh ishin qato pushimet kur vishe këtu, Kosova hala ka qenë në tension...

Petrit Selimi: Ma s’pari ka qenë çudi që visha këtu, se njerëzit kur kanë dalë jashtë kanë qenë në azil edhe s’kanë mujtë ma me u kthy. Domethanë, shumë pak njerëz kanë shku edhe jonë kthy për pushime edhe unë e kom pasë nji fat që kom mujtë m shku edhe me u kthy verës se 99 përqind e njerëzve s’jonë kthy kurrë verës. Edhe menxi s’kom pritë me u kthy, natyrisht, se kom pasë shokë këtu,

familja jeme, edhe përkundër tensionit që u kanë, prapë je kanë në shpi tane, në familjen tane me shokët e tu edhe me jetën tane sociale.

Jom knaqë verave, edhepse u kanë situata larg prej kënaqësisë. Kështu që, u kanë gjithmonë njifarë konflikti midis jetës shumë të mirë, të qetë, të bukur në Norvegji edhe jetës t' tmerrshme këtu. Edhe natyrish masnej e kundërtat, jetës së ngrrohtë familjare e sociale këtu edhe jetës ma të ftoftë në Norvegji, po masnej diqysh u balancun edhe u kriju njifarë balanci midis jashtit edhe mrena.

Aurela Kadriu: Çka bonët mas studimeve?

Petrit Selimi: Nji kohë jom marrë... kom punu në "IPKO," masnej kom punu në OSBE si zyrtar...

Aurela Kadriu: Këtu në Kosovë?

Petrit Selimi: Në Kosovë, po, zyrtar për media. Masnej jom kanë redaktor në gazeten "Java" të Migjen Kelmendit. Në të vërtetë njiherë jom kanë, kur u ba "Zëri Ditor" te Blerim Shala, gazetar po masnej edhe nji redaktor i faqeve të mesme me thanë, të argëtimit edhe të... qato sene që i kom ba ma herët, po veç u ripaketun edhe u ribanë knej në jetën e maslufës. Masnej së bashku me do shokë gazetarë, me ndihmën e financimit prej miqve në "IPKO" e themelum gazeten "Express". Kështu që, jom kanë drejtori i parë ekzekutiv i gazetës "Express" kur ka qenë gazetë edhe portal.

Në ndërkohë qatëherë në 2006-2007 njifarë ndoshta talenti minimal për marrëdhie me publik e kom përdorë si konsulent, kom punu për disa firma të huja. Në 2009-tën, '10-tën kom hy në politikë edhe në 2011-tën jom emëru si zavendës ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, pozitë që e kom pasë në dy mandate. Vjet, në 2016-tën jom ba Ministër i Punëve të Jashtme në detyrë sepse ish-ministri Hashim Thaçi u ba president, kështu që nja pesë-gjashtë muj meta si ministër.

Deri pak vonë, në verë të vitit të kalum ku mas nji oferte që më erdh prej Washingtonit vendosa ta udhëheqi nji fond investiv që quhet "*Millenium Challenge Corporation*" që ka ndërmend me ia nisë këtë verë, 2017-tën me investime në çështje si ambienti, energjia e ripërtirishme, sundimi i ligjit.

Po hala kom kontakt me shumë prej ish- "Post-pesimistave", edhe jashtë edhe mrena. Bile jom t'u e shkrujtë nji kapitull të nji libri për "Post-pesimistat" që është t'u u botu në Norvegji edhe muj me thanë që qajo eksperiencë e atëhershët, shumë prej neve na ka ba qata që jemi sot, çkado që jemi sot, mirë apo keq.

Aurela Kadriu: Falemnderit shumë!

Petrit Selimi: Falemnderit edhe juve shumë!